



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinesica Org.Unit	<i>DMMU</i>
Nr.i Fageve Br. Stranica No. Pages	<i>-05-</i>
Nr.i Prot. Broj Prot. Prot. No.	<i>0459-2/24</i>
Datë Datum Date	<i>02.04.25</i>
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	03.03.2025
REFERENC-Ë:	24/8459/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Happy" Sh.p.k. Konjuh, Lipjan
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 24/8459/825/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së Kompanisë "Happy" Sh.p.k Konjuh, Lipjan – për fabrikën për prodhimin e pecetave të lagura dhe detergjenteve të lëngshëm në Konjuh, Lipjan dhe Livagje, Graçanicë.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Përfundim të procedurës administrative të kërkesës së kompanisë Happy” Sh.p.k Konjuh, Lipjan e cila ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për fabrikën për prodhimin e pecetave të lagura dhe detergjenteve të lëngshëm në ngastrat kadastrale me Nr. 00534-6, 00534-5 dhe 00033-2, ZK. Konjuh në komunën e Lipjanit, 02003-7 dhe 02003-8 në ZK. Livagjë, komuna e Graçanicës.

A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë “Happy” Sh.p.k Konjuh, Lipjan – për fabrikën për prodhimin e pecetave të lagura dhe detergjenteve të lëngshëm në Konjuh, Lipjan dhe Livagjë, Graçanicë, është konstatuar se mungon dokumentacioni si në vijim:

- Kontrata për shfrytëzimin e ngastrave (e noterizuar);

Faqe 2 nga 3



- Certifikata e Pronës, për ngastrat: P-73409043-02003-7 dhe P-73409043-02003-8
- Kopja e Planit, për ngastrat: P-73409043-02003-7 dhe P-73409043-02003-8;
- Pëlqimi i Komunës, për ngastrat: P-71409036-00534-5 dhe P-71409036-00033-2 në Konjuh Lipjan dhe për ngastrat: për ngastrat: P-73409043-02003-7 dhe P-73409043-02003-8 në Liagjë, Graçanicë;

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Happy" Sh.p.k Konjuh, Lipjan, me datën 14.01.2025 është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara nuk janë sjellë në bazë të njoftimi për plotësim të dokumentacionit të datën 14.01.2025.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr vendim për **Përfundimin e Procedurës Administrative** të kërkesës për pajisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë Happy" Sh.p.k Konjuh, Lipjan e cila ka aplikuar për tu pajisur me Pëlqim Mjedisor për fabrikën për prodhimin e pecetave të lagura dhe detergjenteve të lëngshëm në ngastrat kadastrale me Nr. 00534-6, 00534-5 dhe 00033-2, ZK. Konjuh në komunën e Lipjanit, 02003-7 dhe 02003-8 në ZK. Livagjë, komuna e Graçanicës.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/8459/1- ZSP/ /25 datë: 03.03.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Lipjanit
5. Graçanicës
6. Kabinetit të Ministrit
7. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivot të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPHI

Faqe 3 nga 3